



BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

OBJEKTI :

**RIKONSTRUKSION I RRUGËVE TË PARCELAVE TË
FSHATRAVE TË BASHKISË ROSKOVEC**

RELACION TEKNIK

Miratohet :
Kryetari i Bashkisë
Majlinda Buri

Objekti:Rikonstruksioni I rrugëve të parcelave të fshatrave të Bashkisë Roskovec.

Bashkia Roskovec në kuadër të zhvillimit të fshatrave përbërës të bashkisë ,ka ndërmarrë iniciativën për riparimin dhe hapjen e rrugëve të parcelave në këto fshatra.

Riparimi dhe rikonstruksioni i këtyre rrugëve do të ketë një aspekt pozitiv në zhvillimin ekonomik të këtyre fshatrave.Gjithashtu do të mundësojë edhe krijimin e lehtësirave ,sa l peërkjet transportimit të produkteve bujqësore për të cilat shquhet kjo zonë.

Rrugët e parcelave ,të cilat do të riparohen/rikonstruktohen janë:

1-Rrugë parcele fshati Jagodinë,L=870 ml,B=3.0 m+2*0.5 m

2-Rrugë parcele ,fshati Vlosht ,L=1000 ml ,B=3.0m.

3-Rrugë parcele ,fshati Mbërs ,L=900 ml ,B=3.0m.

4-Rrugë parcele fshati Luar ,L=1130 ml,B=3.0 m.

5-Rrugë parcele,fshati Vidhisht ,L=685 ml ,B=3.0 m.

6-Rrugë parcele fshati Kuman ,L=1240 ml ,B=3.0 m.

7-Rrugë parcele ,fshati Marinëz,L=1500 ml ,B=3.0 m.

8-Rrugë parcele,fshati Suk 1,L=1700 ml dhe B=3.0+2*0.5 m.

9-Rrugë parcele,fshati Suk 2,L=820 ml dhe B=3.0 m.

10-Rrugë parcele,fshati Arapaj,L=720 ml ,B=3.0 m.

11-Rrugë parcelash ,fshati Kurjan,Strum ,Velmish ,L=1150+1150+1830 ml ,B=3.0 m.

Më poshtë një përshkrim I gjendjes ekzistuese të rrugëve:

1-Rrugë parcele fshati Jagodinë,L=870 ml,B=3.0 m+2*0.5 m



Rruga ndodhet në fshatin Jagodinë ,njësia administrative Kuman.Rruga ka një gjatësi prej 870 ml dhe gjerësi 3.0 m.Gjysma e rrugës është e shtruar me rërë bituminoze dhe gjysma tjetër me çakëll.Si pasojë e ngarkesës së mjeteve rruga është amortizuar.Në rrugë janë shfaqur gropa dhe lëvizja e mjeteve është tejet e vështirë.

Nevojitet skarifikim i rruges në pjesën me çakëll ,mbushja e gropave në rrugën me çakëll dhe me rërë bituminoze,hedhja e një shtresë stabilizanti me trashësi t=5 cm dhe një shtresë rërë bituminoze me trashësi t=8 cm sipër shtresës ekzistuese të çakëllit.Në pjesën e bankinës nevojitet ulja e tyre dhe hedhja e një shtrese çakëlli me trashësi t=10 cm.

2-Rrugë parcele ,fshati Vlosht ,L=1000 ml ,B=3.0m.



Kjo rrugë gjendet në fshatin Vlosht,njësia administrative Kurjan .Rruga është 1000 ml dhe ka një gjerësi prej 3.0m.Është një nyje e rëndësishme ,sepse lidh këtë fshat me parcelat e tij .

Rruga është tejet e amortizuar dhe e degraduar, duke e bërë të pakalueshme nga ana e mjeteve dhe makinerive bujqësore.

Nevojitet hapja e një traseje të re në gjurmën ekzistuese të rrugës dhe hapja e kanalit anësor,që do të shërbejë për kullimin e ujërave të shiut.

3-Rrugë parcele ,fshati Mbërs ,L=900 ml ,B=3.0m.



Kjo rrugë gjendet në fshatin Mbërs, njësia administrative Kurjan. Rruga është 900 m dhe ka një gjerësi prej 3.0 m. Është një nyje e rëndësishme, sepse lidh këtë fshat me parcelat e tij.

Rruga është tejte e amortizuar dhe e degraduar, duke e bërë të pakalueshme nga ana e mjeteve dhe makinerive bujqësore.

Nevojitet hapja e një traseje të re në gjurmën ekzistuese të rrugës dhe hapja e kanalit anësor, që do të shërbejë për kullimin e ujërave të shiut.

4-Rrugë parcele fshati Luar, L=1130 m, B=3.0 m.





Kjo rrugë ndodhet në fshatin Luar, Njësia Administrative Kuman. Rruga është 1130 ml dhe e gjerë 3.0 m. Është e shtruar me çakëll në një pjesë të vogël të gjatësisë së saj, ndërsa pjesa tjetër është më dhe (tokë natyrore).

Është e nevojshme skarifikimi i rrugës, sistemimi, nivelimi dhe mbushja në trupin e rrugës, si dhe hedhja e një shtrese çakëlli me gur kave nga gurorja me trashësi $t=20$ cm.

5-Rrugë parcele, fshati Vidhisht, L=685 ml, B=3.0 m.





Rruga ndodhet në fshatin Vidhisht ,Njësia Administrative Kuman .

Është e gjatë 685 m dhe e gjerë 3 m.Gjendja e saj paraqitet e amortizuar ,si pasojë ka nevojë për skarifikim ,sistemim ,nivelim dhe mbushje në trupin e rrugës ,si dhe hedhja e një shtrese çakëlli me trashësi t=10 cm.

6-Rrugë parcele fshati Kuman ,L=1240 m ,B=3.0 m.





Rruga ndodhet në fshatin Marinëz, Njësia Administrative Kuman .

Rruga është e gjatë 1500 m dhe e gjerë 3.0 m. Rruga është e amortizuar, ka nevojë për gërmim , nivelim dhe sistemim të shtresës ekzistuese e cila është rrugë dheu dhe hedhjen e një shtrese çakëlli me gur kave me trashësi $t=20$ cm .

8-Rrugë parcele, fshati Suk 1, $L=1700$ m dhe $B=3.0+2*0.5$ m.





Rruga ndodhet në fshatin Suk 1, Njësia Administrative Strum .Rruga është e gjatë 1700 ml dhe e gjerë 3.0 m. Aktualisht rruga është e shtruar me çakëll ,por e amortizuar. Ka nevojë për ulje të bankinave ,hedhjen e një shtrese çakëlli me trashësi t=10 cm në bankine.

Në rrugë ka nevojë për skarifikim ,sistemim dhe mbushje të gropave ,si dhe hedhjen e një shtrese stabilizanti me trashësi t=5 cm dhe një shtrese me rërë bituminoze me trashësi t=8 cm .

9-Rrugë parcele, fshati Suk 2, L=820 ml dhe B=3.0 m.





Rruga gjendet në fshatin Suk 2 ,Njësia Administrative Strum .

Është e gjatë 820 m dhe e gjerë 3.0 m. Rruga është rrugë me dhe (shtresë toke natyrore).Nevojitet gërmim ,sistemim ,nivelim I trupit të rrugës dhe hedhja e një shtrese çakëlli me trashësi t=10 cm ,e një shtrese stabilizanti me trashësi t=5 cm ,dhe e një shtrese me rërë bituminoze me trashësi t=8 cm .

10-Rrugë parcele,fshati Arapaj,L=720 m ,B=3.0 m.





Rruga ndodhet në fshatin Arapaj, Njësia Administrative Strum.

Rruga është e gjatë 720 m dhe e gjerë 3.0 m. Rruga është e amortizuar, ka nevojë për gjermim, sistemim, nivelim të trupit të rrugës, hedhja e një shtrese stabilizanti me trashësi $t=5$ cm dhe një shtrese rëre me trashësi $t=8$ cm.

11-Rrugë parcelash, fshati Kurjan, Strum, Velmish, $L=1150+1150+1830$ m, $B=3.0$ m.



Këto rrugë gjenden në fshatrat Kurjan Velmish ,Strum ,Njësitë Administrative Kurjan ,Strum .Gjatësia e përgjithshme e rrugëve është 4130 m dhe gjerësi 3.0 m. Është e nevojshme gërmimi ,sistemimi, nivelimi I trupit të rrugës dhe hedhja e një shtrese çakëlli me trashësi t=10 cm.Gjithashtu në një pjesë të rrugës së fshatit Kurjan nevojitet hapja e trasesë së rrugës dhe vendosja e tombinove me diameter D=600 mm.

Ing.Romeo Kodheli

